

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN STRUKTUREN DHE FUNKSIONIMIN  
E BASHKËSIVE LOKALE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË  
PRISHTINËS

Prishtinë qershor 2001

Në bazë të nenit 4 dhe 5 të Rregullorës nr. 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, dhe në harmoni me nenin 8 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me 19.07.2001 miratoi:

## **RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN, STRUKTUREN DHE FUNKSIONIMIN E BASHKËSIVE LOKALE NE TERRITORIN E KOMUNËS SE PRISHTINËS**

- Dispozitat e përgjithshme

### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore në harmoni me dispozitat pozitive (të aplikueshme) ligjore në Kosovë, dhe me dispozitat e Statutit të Komunës së Prishtinës, parashihet organizimi, struktura dhe funksionimi i bashkësive lokale që gravitojnë në teritorin e Komunës së Prishtinës.

### **Neni 2**

Territori i Komunës së Prishtinës, numëron gjithsej 36 bashkësi lokale, prej të cilave 20 janë lagje urbane të qytetit të Prishtinës, ndërsa 15 bashkësi lokale tjera kanë statusin e fshatrave.

Organizimi dhe struktura – përkufizimi

### **Neni 3**

Për të realizuar sa më mirë funksionet e parapara me nenin 11 të Rregullorës nr.2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave dhe nenit 7 të Statutit të komunës së Prishtinës, Komuna e Prishtinës ndahet në 20 lagje të qytetit dhe 15 bashkësi lokale fshatare (rurale).

### **Neni 4.**

Përkufizimi i lagjeve të veqanta urbane të qytetit të Prishtinës, bëhet si vijon:

#### **-Lagja (Bashkësia lokale) nr. I**

**I.** Territori i parë përfshinë pjesën e qytetit në anën e djathtë të rrugës “Iliir Kuneshevc” deri të Sheshi “Adem Jashari”, pastaj anës së djathtë rruges “Elena Gjika”

Deri te udhëkryqi në rrugën “Pal Palucaj”, mandej anës së djathtë të rrugës “Pal Palucaj” deri te udhëkryqi në rrugën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, deri te kryqëzimi i saj në rrugën “Garibaldi”, pastaj rrugës “Garibaldi” deri te rruga “Kosta Novakoviq” Madje nëpër vijën e ardhshme trafike në mes të Pallatit të Shtypit dhe Qendrës Sportive deri te rruga e UCK, duke vazhduar deri te Centrali i vjetër dhe anës së djathtë të rrugës së UCK deri te rruga “Ilir Kunushevc” para Sheshit “Adem Jashari”.

### **Lagja (Bashkësia lokale) nr. II**

2. Territori i dytë përfshin pjesën e qytetit prej udhëkryqit të rrugë „Garibaldi“ dhe bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, anës së djathtë deri te semafori në udhëkryqin në rrugën “Bill Klintoni”, pastaj anës së djathtë të kësaj rruge deri te ura në lagjen e Arbrisë, pastaj vazhdon përgjatë hekurudhës deri te hyrja në pallatin e shtypit, në rrugën Podujevë-Pejë, dhe vijës së ardhshme trafikore në mes të Pallatit të Shtypit, rrugës “Garibaldi” dhe nëpër këtë rrugë deri te rruga Builevardi “Dëshmorët e Kombit”

### **Lagja (Bashkësia lokale) nr.III**

3. Territori i tretë përfshinë pjesën e qytetit prej bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, rrugës “Bill Klintoni” dhe “Pal Palucaj”, vazhdon anës së djathtë të Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, deri në lagjen e Spitalit, pastaj prej udhëkryqit të përmendur anës së majt të rrugës “Bill Klintoni” deri te fabrika e “Amortizatoreve”, duke përfshirë edhe zonën industriale.

### **Lagja (Bashkësia lokale) nr. IV**

4. Territori i katërt përfshin një pjesë të Ulpianës, siq vijon: Prej udhëkryqit të rrugës “Bill Klintoni”, “Pal Palucaj” dhe Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, pastaj anës së djathtë të rrugës “Pal Palucaj” deri te udhëkryqi në rrugën “Elena Gjika”,. Deri te sheshi “Isa Boletini”, mandej anës së djathtë të rrugës “Imzot Nikprela”(objektet E –30, E-31,E-32 dhe Shkollës “Hasan Prishtina”), dhe zbret buzë qendrës tregtare, në rrugën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, te tregu i gjelbërt në Ulpianë dhe rrugës Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” deri te kryqëzimi me rrugën “Bill Klintoni”.

### **Lagja (Bashkësia lokale)nr. V.**

5. Territori i pestë përfshinë pjesën e qytetit prej tregut të gjelbërt në Ulpianë, shkon anës së majtë të Bulevardit ”Dëshmorët e Kombit” deri te lagja e Spitalit, pastaj prej tregut të gjelbërt në Ulpianë, vijës së rrugës “Imzot Nikprela”(të objekteve E-30,E-31,E-32,dhe të shkollës “Hasan Prishtina”). deri te sheshi ”Isa Boletini”, mandej anës së djathtë të rrugës “Elena Gjika”, kah udhëkryqi te spitali i Ri., e pastaj anës së djathtë të rrugës në drejtim të Arkivit të Kosovës dhe mëtutje përfshinë pjesën e ndërtimit industrial pas spitalit.

### **Lagja (Bashkësia lokale) nr. VI.**

6. Territori i gjashtë përfshin pjesën e qytetit prej udhëkryqit të rrugës “Elena Gjika”dhe “Arkitetkti Karl Gega”,deri te rruga “Rexhep Mala”mandej anës së djathtë të

rrugës “Rexhep Mala”deri te prrocka e dikurshme, pastaj përgjatë prrockës deri te sokaku në rrugën “Gazmend Zajmi” dhe anës se djathtë të kësaj rruge deri te prrocka e Matit (ish Matiqani) deri te vija e re e trafikut mbi kompleksin e Spitalit , pastaj deri te udhëkryqi në rrugën “Elena Gjika”dhe pastaj këtij udhëkryqi anës së djathtë të rrugës “Elena Gjika” deri te rruga “Arkitekt Karll Gega”Shulemaja”,”Halil Alidema”,”Tringe Smajli”,

### **Lagja(Bashkësia lokale) nr.VII**

7. Territori i shtatë përfshinë një pjesë të Mëhallës së Muhaxherëve dhe Panairi me këto rrugë:Arkitekt Karl Gega”,”Rexhep Mala” deri te rruga “Lord Bajroni”, rruga Kaqaniku”deri te Varrezat Perkujtimore , nëpër rrugën “Norbert Jokl”,rrugët “Sokol Sopi”, “Adrian Krasniqi”,”Rrustem Statoci”,”Ali Kelmendi” deri te rruga “Gazmend Zajmi”,nëpër rrugën “Abdyl Frashëri”deri te rruga ‘Gazmend Zajmi”, nëpër rrugën “Mbreti Longar”, anën e djathtë të rrugës “E.Gjika”deri te ndërmarrja “Duhani”anës së djathtë të rrugës “Bajram Kelmendi”nëpër rrugën “Svetozar Markoviq”deri te rruga “Hamzë Jashari”,rrugët “Demë Ahmeti”,Zeki Shulemaja”,”Halil Alidema”,”Tringë Smajli”, prej rrugës “Elena Gjika”,”Gustav Majer”dhe Afrim Vitija”.

#### Lagja(Bashkësia lokale ) VII –1.

7.1 Territori shtatë një, përfshinë këto rrugë: Rruga “Mustafë Kruja” dhe Mustafë Hoxha”,”Svetozar Markoviq”,”Shaip Kamberi”,”Isa Boletini”,”Edmond Hoxha”,”Rrustem Hyseni”deri te rruga “Afrim Loxha”,.mandej deri te ura dhe rruga “Xhavit Mitrovica”.

#### Lagja(Bashkësia lokale) VII-2

7.2. Territori shtatë dy, përfshinë lagjen Velani deri te poligoni i qitjes, Lagjen prej Varrezave Perkujtimore, në drejtim të Matit (ish Matiqani) në të dy anët dhe fshatrat Lugmir e Matit (ish Matiqani)

### Lagja (Bashkësia lokale) nr. VIII

8. Territori i tetë përfshinë pjesën e qytetit prej kryqëzimit të rrugës “Elena Gjika” me rrugën “Bajram Kelmendi”, pastaj anës së djathtë të rrugës “E.Gjika” deri te kryqëzimi me rrugën “Nazim Gafurri”, deri te dalja nga qyteti , pastaj vazhdon anës së

majtë përpjetë rrugës “:B.Kelmendi” dhe të projit të Lugmirit,duke përfshirë edhe Sefalinë.

#### Lagja(Bashkësia lokale) nr. IX.

9. Territori i nëntë përfshinë anën e djathtë të rrugës “Haxhi Zeka”, anën e djathtë të rrugës “Hasan Remniku”,Kolovicën, Kolonine e Re,Projin e Popit,. Rruget “Dervish Cara”,”Fehmi Krasniqi”,Salih Mani”, Abdyl Frashri”, “Azem Bejta”,”Fan Noli”dhe rruget “Afrim Loxha”pjesa e dytë.

#### Lagja (Bashkësia lokale) nr. IX-1

Territori i nëntë një përfshinë anën e majtë të rrugës “Nazim Gafirri”, rruget “Bedri Sokoli”, “Rasim Kiqina”,” Nikola Teslla”, “Ismet Jashari –Kumanova”, “Hoxhë Hasan Tahsini”,”Hilë Mosi”,”Rexhep Shema”,”Ymer Lutfi Paçarizi”, “Visar Dodani”, “Hyzri Talla”,”Xhavit Ahmeti” deri në Gërmi.

#### Lagja (Bashkësia lokale) nr. X.

Territori i dhejtë përfshinë pjesën e qytetit prej kryqëzimit të rrugëve “Ilir Kunushevc” dhe “Nazim Gafurri”, pastaj shkon anës së majtë të rrugës “ N.Gafurri” deri te Qendra Teknike , mandej anës së majtë të rrugëve “Haxhi Zeka”dhe “Hasan Remniku” deri te dalja nga qyteti, e madje prej të njëjtit udhëkryq anës së djathtë të rrugës “Ilir Kunushevc” “deri te ura e Lumit Prishtina dhe anës së djathtë të Lumit Prishtina, përgjatë rrjedhës së lumit deri te hyrja e tij në qytet.

#### Lagja (Bashkësia lokale) nr. XI

Il. Territori i njëmbëdhjetë përfshinë pjesën e qytetit deri te ura mbi lumin Prishtina, në rrugën “Ilir Kunushevc”, madje shkon anës së majtë teposhtë lumit Prishtina , përgjatë rrjedhës së lumit deri te dalja nga qyteti, pastaj prej urës mbi lumin Prishtina në rrugën “Ilir Kunushevc”, anës së djathtë të rrugës “Ilir Kunushevc”, deri te hekurudha që shkon në drejtim të Podujevës, e mandej anës së djathtë të kësaj hekurudhe deri te dalja nga qyteti.

#### Lagja (Bashkësia lokale) nr. XII.

Territori i dymbëdhjetë përfshinë këto rrugë: “Mentor Retkoceri”, “Mbreti Pirro”,”Ramë Govori”,”Osman Bunjaku”, Ismet Dërguti” dhe “Shaban Shala”.

Lagja (Bashkësia lokale ) XII-1.

12.1. Territori I dymbdhjet nje perfshine rruget : “Vllezrit Fazliu”, “Burim Grajqevci” dhe “Adem Keqekolla”.

Lagja (Bashkësia lokale) XII-2.

12.2. Territori dymbdhjete dy perfshine rruget :Rr. E”Vushtrriss”,anen e djathte te rrugeve “Gjon Sereqi”, “Verrat e Llukës”,”Bedri Gjini”, dhe Carraleva”

Lagja (Bashkësia lokale) nr. XIII.

Territori i trembëdhjetë përfshinë pjesën e qytetit prej urës së lumit Prishtina në rrugën “Ilir Kunushevc”, pastaj shkon anës së majtë të kësaj rruge deri te hekurudha që vjen prej Podujevës në drejtim të Fushë Kosovës, mandej anës së majtë të hekurudhës në drejtim të Fushë Kosovës deri te rruga “Kajtaz Ramadani”, e pastaj anës së majtë të rrjedhës së lumit Prishtina deri te ura në rrugën “Ilir Konushevc”.

Lagja (Bashkësia lokale) nr. XIV.

Territori i katërbëdhjetë përfshinë pjesën e qytetit prej lumit Prishtina, në rrugën “Ilir Kunushevc”, pastaj shkon anës së djathtë të kësaj rruge deri te sheshi “Adem Jashari”,mandej anës së djathtë të rrugës së UÇK-së deri te ura e lumit Prishtina dhe më tutje anës së djathtë të rrjedhës së këtij lumi deri te ura në rrugën “Ilir Kunushevc”.

Lagja (Bashkësia lokale) nr. XV.

15. Territori i pesëmbëdhjetë përfshinë pjesën e qytetit prej kryqëzimit të rrugës së “Vushtrrisë” me hekurudhën , pastaj shkon anës së majtë të rrugës në drejtim të Varrezave Muslimane e mandej prej të njëjtit kryq anës së djathtë të hekurudhës për Fushë Kosovë , deri te rajoni i Fushë Kosovës dhe i Shkabajt.

Neni 5.

Organizimi i fshatrave bëhet sipas lokaliteteve fshatare të organizuara në Bashkësi lokale (Bashkësi vendore) si vijon:

Territori i Bashkësisë XIX-lokale

19. Territori i nëntëmbdhjete përfshine fshatin: Graqanicë.

#### Territori i Bashkësisë XIX-1 lokale

19-1. Territori i nëntëmbdhjetë- një përfshin : Kolonin e xehërores “Hajvali” dhe fshatrat Guran ( ish Shushica ) , Sasaj ( ish Shashkovci ) , Kishëz ( ish Kishnica ) dhe Badoc .

#### Territori i Bashkësisë XX-lokale

20. Territori i njëzetë përfshinë fshatrat:Dushkajë(ish Dabisheci),Gjelbrishtë(ish Hajkobilla) dhe Murrizaj(ish Gllogovica).

#### Territori i Bashkësisë XXI-lokale

21.Territori i njëzetë e njëte përfshinë fshatrat:Keqekollë,Prapashtizë(ish Prapashtica),Nishec dhe Ballaban.

#### Territori i Bashkësisë XXII-lokale

22.Territori i njëzetëe dytë përfshinë fshatin:Kolaj(ish Koliqi)

#### Territori i Bashkësisë XXIII-lokale

23.Territori i njëzetë e tretë përfshinë fshatrat:Besi,Dafinet(ish Vranidolli),Tenesh(ish Tenezhdolli) dhe Rimanishtë.

#### Territori i Bashkësisë XXIV-lokale

24.Territori i njëzetë e katërt përfshinë fshatrat:Progos(ish Prugofci) dhe Lebanë.

#### Territori i Bashkësisë XXV-lokale

25.Territori i njëzetëe e pestë përfshinë fshatrat:Barilaj(ish Barileva) dheDrenosh(ish Drenofci).

#### Territori i Bashkësisë XXVI-lokale

26.Territori i njëzetë e gjashtë përfshinë fshatrat:Bardhoshë(ish Jugoviqi) Rrezanë(Bërrnica e epërme),Bërrnik(ish Bërrnicae poshtme),Gur kuq(ish Truda).

Territori i Bashkësisë XXVII-lokale

27.Territori i njëzetë e shtatë përfshinë fshatrat:Lugar(ish Llukari),Gjytet ( ishGrashtica )Makaj(ish Makofci) ,Kalajas(ish Siqeva),Radesh(ish Radashefci) dhe Sharban.

Territori i Bashkësisë XXVIII-lokale

28.Territori i njëzetë e tetë përfshinë fshatrat:Llapllasellë,Preocë dhe Çagllavicë.

Territori i Bashkësisë XXIX-lokale

29.Territori i njëzetë e nantë përfshinë fshatatin:Hajvali.

Territori i Bashkësisë XXX-lokale

30. Territori i tridhjetë përfshinë fshatin:Shkabaj(ish Orlloviqi).

Territori i Bashkësisë XXXI-lokale

31.Territori i tridhjetë e njëtetë përfshinë fshatrat:Thanishtë(ish Slivova),Drankaj(ish Dragoci) dhe Kukaj(ish Kukavica).

Territori i bashkësisë XXXII-lokale

32.Territori i tridhjetë e dytë përfshinë fshatrat:Mramuer,Busi dhe Zllashë.

Territori i Bashkësisë XXXIII-lokale

33.Territori i tridhjetë e dytë përfshinë fshatin:Marec.

Neni 6.

Përfshirja nga neni paraprak fshatrat me pëlqimin e tyre mund të bashkohen në organizime të përbashketa dhe me këto rast formojnë bashkësinë vendore të përbashketa të fshatrave që bashkohen.Vendimi për bashkimin në Bashkësinë vendore të fshatrave e bjen qdo fshat në mënyrë të pavarur me deklaratim të shumicës së banorëve të qdo lokaliteti përkatës.



## Organet e bashkësisë- lokalitetit

### Neni 7.

Lagjet (Bashkësitë vendore) urbane respektivisht lokalitetet fshatare zgjedhin Këshillin e Bashkësisë , ose të fshatit përmes votimit të fshehtë apo të hapur në tubimin e qytetarve. Këshilli i bashkësisë apo i fshatrave nga radhët e tij zgjedhë Kryetarin e Këshillit.

Në përbërjen e Këshillit duhet të përfshihen i gjithë spektri politik i atij mesii, në harmoni me përqindjen e fituar të subjekteve politike në zgjedhjet lokale .

Këshilli i bashkësisë – lokalitetit mund të ketë prej 5 deri në 17 anëtar. Numri i saktë i anëtarëve përcaktohet me vendim të Kuvendit të Bashkësisë – lokalitetit përkatës .

Këshilli zgjedhet me mandat 4 vjeçar, poashtu edhe kryetari i këshillit.

Kryetari dhe anëtarët tjerë të këshillit aktivitetin e tyre konform me këte rregullore e zhvillojnë në baza vullentare – pa kompenzim të ardhurash personale.

Këshilli , anëtarët dhe kryetari i këshillit mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit , nëse nga zgjedhësit e tyre konstatohet se kanë lëshime në punët e tyre.

### Neni 8.

Në baze të nevojave dhe të kërkesës së qytetarëve të bashkësisë lokale ose të ndonjë lokaliteti, apo me inisiativën e Këshillit të Bashkësisë lokale , mund të përcaktohet grumbullimi i vetkontributit të qytetarëve konform me dispozitat e Statutit të Komunes së Prishtinës.

### Neni 9.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë:

1. Nxjerr rregulloren e punës;
2. Nxjerr vendimin mbi organizimin e lagjes urbane ose lokaliteteve fshatare (me specifrikat organizative);
3. Organizon, përcjellë dhe planifikon zhvillimet e lokalitetit në bashkëpunim me Kuvendin Komunal , me komitetet e tij dhe drejtoritë komunale ;
4. Emëron komisionet përkatëse për të realizuar objektivat e lagjes urbane- lokaliteteve fshatare nga ky nen.
5. Harton planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat , planifikon mjetet dhe shpërndarjen e tyre sipas destinimit dhe vendimeve përkatëse të miratuara në Këshill ose me deklaramë referendum të lokalitetit përkatës.

**6.** Ndërmerr iniciativa përkatëse për destinimin dhe ruajtjen e objekteve në pronësi shtetërore dhe pasurive tjera të paluejtshme shtetërore në lokalitetin përkatës .

**7.** Bën llogarinë 6 mujore dhe atë vjetore të mjeteve të inkasuara në lagje –lokalitet dhe i bënë ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti në harmoni me dispozitat e Statutit të Komunës së Prishtinës.

**8.** Siguron të dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës , përcjellë gjendjen ekonomike të tyre dhe jep rekomandime e propozime në lidhje me këto.

**9.** Nga rradhët e këshillit caktohet personi i cili do të ngarkohet me bllokat për përcjelljen e gjendjes financiare të lokalitetit sipas kategorive të cilat caktohen me vendim të posaqëm të Këshillit të lagjes (urbane) –përkatësisht të lokalitetit.

**10.** Përveç kompetencave të numëruara në këtë nenë Këshilli i lagjes - lokalitetit nxjerr vendime , rekomandime, urdhëresa , udhëzime dhe akte të tjera që kanë të bëjnë me lokalitetet përkatëse.

#### **Neni 10.**

Drejtoria për administratë të përgjithshme e Kuvendit Komunal të Prishtinës , koordinon punët në lagjet urbane dhe lokalitetet fshatare të Komunes së Prishtinës, përmes Kryetarëve të Këshillave të lagjeve dhe në bashkëpunim me Kuvendin , komitetet e tij dhe drejtoritë tjera të Kuvendit Komunal të Prishtinës , v aresisht nga specifikat që do të trajtohen.

#### **Neni 11.**

Për të gjitha punët e parapara në nenin 9 të kësaj Rregulloreje Këshilli I lagjes (urbane) apo I lokalitetit përkatës mban obligime dhe përgjegjësi në rast të keqpërdorimit eventual.

Përgjegjësia mund të jetë individuale apo kolektive para qytetarëve dhe organeve përkatëse.

#### **Neni 12.**

Me vendim të Kuvendit Komunal të Prishtinës e me rekomandim të Komitetit për politike dhe financa , me kërkesën e lagjes urbane ,respektivisht lokalitetit përkatës fshatare , disa punë që janë në përgjegjësinë e Komunës mund të barten dhe të ushtrohen në fshatra dhe vendbanime - lagje urbane(Bashkësi lokale).

### **Dispozitat përfundimtare**

### **Neni 13.**

Ne rast kundërshtimi të ndonjë dispozite të kësaj rregulloreje dhe akteve të nxjerra nga organet e lagjeve urbane e fshatare {Bashkësive lokale}, me dispozitat e rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës dhe Statutit të Komunës së Prishtinës do të aplikohen dispozitat e UNMIK-ut {nr.2000/45} dhe ato të Statutit të Komunës së Prishtinës.

### **Neni 14.**

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së të njëjtes.

### **Neni 15.**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

Nr. \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

**KRYETARI I KUVENDIT**

**Dr . Salih GASHI**